

# Biblioteka integruese për të rriturit: Të mësosh gjermanisht



## ÇKA OFRON SATELITI «TË MËSOSH GJERMANISHT»?

- Domeni «Të mësosh gjermanisht» ua lehtëson personave me gjuhë të huaj amtare hyrjen në gjuhën gjermane.
- Oferta përbëhet nga kurset e gjermanishtes për të gjitha nivelet, tekstet përcjellëse për kurset ose kurset për mësim të pavarur të gjermanishtes të regjistruar në të gjitha llojet e mjeteve memoruese. Oferta përfshin edhe kurse dygjuhësore të gjermanishtes, do me thënë me përkthime në gjuhën gjegjëse, fjalorë, tekste të thjeshta në formë librash ose në audio, CD dhe tekste dygjuhësore.
- Ofrohen edhe informacione për kurset e gjuhës gjermane në Winterthur dhe rrethinë.
- Vende të posaçme të punës, stacione kompjuterësh dhe interneti janë rezervuar në bibliotekë për mësimin e pavarur të gjermanishtes.

## KUSH MUND TA SHFRYTËZOJË BIBLIOTEKËN?

- Biblioteka Integruese – ashtu sikur edhe i tërë rrjeti bibliotekar – është në dispozicion të popullësisë së regjionit të Winterthurit dhe të rrethinës.
- Oferta ju dedikohet në rend të parë të rriturve, të cilët duan t'i përmirësojnë njohuritë e tyre gjuhësore, sidomos ato të gjermanishtes.
- Mësueit gjejnë libra për mësimdhënien e «Gjermanishtes për të huaj».

## SI MUND TË SHFRYTËZOHET BIBLIOTEKA INTEGRUESE?

- Të rriturit paguajnë shumën vjetore prej 50 Fr. (studentët 40 Fr.) me çka teoretikisht mund ta huazojnë tërë asortimentin e bibliotekës. Shfrytëzimi i ofertës është pa pagesë.
- Karta e Bibliotekave të Winterthurit mund të merret tek sporteli i shërbimit të klientëve në katin përdhësë të bibliotekës si dhe në të gjitha bibliotekat e kuarteve.
- Mediumet e sektorit «Të mësosh gjermanisht» gjenden në katin e dytë të sipërm. Aty gjenden edhe stacionet e internetit dhe vende të tjera pune në kompjuterë.
- Personeli i bibliotekës ju ndihmon me dëshirë në rast pyetjesh mbi mënyrën e shfrytëzimit.
- Dëshirat në lidhje me blerjen e medimeve të reja mund të bëhen me dije në deskun e katit të dytë të sipërm të bibliotekës.
- Informacione të tjera më të hollësishme mund të merren nga bibliotekistja kompetente Theresa Rice-Schumacher (mail: [therese.rice@win.ch](mailto:therese.rice@win.ch))

Biblioteka Integruese udhëhiqet nga Bibliotekat e Winterthurit dhe është projekt i përbashkët i Bibliotekave të Winterthurit dhe të Forimit Interkulturor Winterthur.

## ORARI I PUNËS

E hënë ora 10–18.30 · e martë, e mërkurë, e premte ora 9–18.30 · e shtunë ora 9–20 · e shtunë ora 10–17